



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2021:099964

Datë: 22.01.2024

Numri i dokumentit: 05221540

PPP.nr. 547/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, me bashkëpunëtorin profesional Festim Zeqiri, në çështjen juridike përmbareme të kreditores Z.D nga Peja, të cilën e përfaqëson Arif Hasi, avokat nga Gllogoci, rruga “Skenderbeu”, kundër debitores Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, rruga “UÇK”, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori me datë 04.08.2020, kundër Urdhrit për lejimin e përmbaremit numër P.nr.166/2020, i datës 23.07.2020, i lejuar nga Zyra Përmbareme e Përmbareusi Privat Irfan I Kërçagu, i emëruar për regjionin e Prishtinës, jashtë seancës gjyqësore, me datë 22.01.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET në tersi i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit, ashtu që :

II. SHFUQIZOHET urdhëri përmbareimor P.nr.166/2020, i datës 23.07.2020 i nxjerrë nga përmbareusi privat Privat Irfan I Kërçagu në Prishtinë, anulohen të gjitha veprimet e kryera deri në këtë fazë të procedurës si dhe përfundohet procedura përmbareme e iniciuar sipas urdhrit përmbareimor P.nr.166/2020, i datës 23.07.2020.

**Arsyetim**

Zyra Përmbareme e Përmbareusit Privat Irfan Kërçagu me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbareim të parashtruar nga i autorizuari i kreditores Z.D, ka lejuar përmbareimin në bazë të Urdhrit Përmbareimor P.nr.166/2020, i datës 23.07.2020, në bazë të dokumentit përmbareimor – Vendimit të Inspektoratit të Punës, 01Nr.08-329/2020, i datës 13.03.2020, dhe ka caktuar përmbareimin ndaj debitorës Komuna e Prishtinës, me ndalesën në llogarinë e debitorit e cila evidentohet pranë Ministrisë së Financave – Departamenti i Thesarit në Prishtinë, në shumën prej 426.00 Euro.

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka ushtruar Prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar përmbarimin me arsyen se i njëjti nuk është i bazuar në dispozita ligjore, duke shtuar se në bazë të nenit 5, par. 6 pika 2 të LPP-së, për çështjet e kthimit në punë të punëtorëve dhe shërbyesve civil dhe kompensimet e tjera, kompetencë ekskluzive ka vetëm gjykata. Nga këto arsye ka vlerësuar se përmbaruesi privat ka nxjerr urdhrin për përmbarim privat jashtë autorizimeve të tija ligjore dhe kompetencës së përcaktuar me ligj. Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë prapësimin dhe të abrogojë Urdhrin për lejimin e përmbarimit, i nxjerrë nga përmbaruesi privat.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, ku ka theksuar se prapësimi duhet të mbështetet në prova të duhura të cilat duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi refuzohet në kuptim të nenit 69 par.4 të LPP-së. Ka theksuar se, në kuptim të nenit 24 par.3 të LPP-së, vendimi i nxjerrë në procedurë administrative, është dokument përmbarimor, sepse ky vendim është nxjerr konform nenit 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ka theksuar se dokumenti përmbarimor në rastin e dhënë, përmban të gjitha informacionet që duhen, se është i ekzekutueshëm dhe se e ka të përcaktuar detyrimin monetar të debitorit ndaj kreditorit. Në lidhje me kompetencën e përmbaruesit privat për të vendosur në këtë çështje, ka theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me një detyrim monetar, dhe jo kthim në punë çështje familjare apo kompensim tjetër dhe se dokument përmbarimor në bazë të së cilit kërkohet përmbarimi është akti administrativ, e jo vendimi gjyqësor, ndaj dhe përmbaruesi privat ka kompetencë për të vendosur. Ka theksuar se qëllimi i debitorit është vetëm shtyrja e përmbarimit duke e kundërshtuar të njëjtin pa pasur mbështetje në dispozita ligjore. Ndaj, gjykatës i ka propozuar që ta refuzojë të njëjtin si të pabazuar dhe të vërtetoj Urdhrin përmbarimor të lëshuar nga përmbaruesi privat, si dhe të obligoj debitorin në kompensimin e shpenzimeve të procedurës për kreditorin.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit duhet të aprovohet si i bazuar, duke konstatuar se, në rastin konkret, përmbarimi sipas propozimit të kreditorit është lejuar pa u plotësuar kushtet ligjore.

Dispozita nga neni 24 par.3 e LPP-së parasheh që: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një dokument përmbarimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbarim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe mungesa e njërit prej tyre në dokumentin përmbarimor, rrjedhimisht ia heqë cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përmbarim.

Në rastin konkret, propozimi për përmbarim është paraqitur duke u mbështetur në Vendimin e Inspektoratit të Punës, 01Nr./08-329/2020, i datës 13.03.2020. Në bazë të shqyrtimit të këtij vendimi, Gjykata gjen se në dispozitiv të të njëjtit është aprovuar si e bazuar ankesa e

kreditores Z.D, dhe është obliguar debitorja që në afat prej 8 ditësh të bëjë kompensimin në vlerë 75% të një page bazë në emër të shpërblimit jubilar dhe shpenzimet e procedurës për përpilimin e ankesës sipas tarifës së OAK-së. Megjithatë, këtij Vendimi i mungon shuma e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorës, si një nga elementet që duhet t'i përmbajë dokumenti përmbarimor për të qenë i përshtatshëm për përmbarim.

Nën këto rrethana, Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi në këtë çështje juridike nuk i përmbushë kushtet për të qenë i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të dispozitës nga neni 27 par.1 lidhur me nenin 24 të LPP-së.

Gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh faktin se në shkresat e lëndës, përveç vendimit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi janë të bashkangjitura edhe prova tjera si: ankesa – kërkesa për njohjen e të drejtës në pagë jubilar nr.prot.1087, dt.20.02.2020, kërkesë për kompensimin e pagës jubilar 03-615/03-0017218/20, dt.22.01.2020, kontratën e punës të dt.01.11.2013, vërtetimin e përvojës së punës, si dh e pasqyrën bankare, mirëpo Gjykata thekson faktin se meqë kemi të bëjmë me procedurë rigorozisht formale siç është procedura përmbarimore, me rastin e vendosjes lidhur me ligjshmërinë e lejimit të përmbarimit, duhet kufizuar vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit përmbarimor, që në rastin konkret është vendimi i Inspektoratit të Punës 01Nr./08-329/2020, i datës 13.03.2020.

Bazuar në këto arsye, meqë Urdhëri Përmbarimor është lejuar mbi bazën e një dokumenti i cili nuk është i përshtatshëm për përmbarim, Gjykata konstatoi se prapësimi i ushtruar nga debitori gjen mbështetje në dispozitën e nenit 71 par.1 pika 1.1 të LPP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e anuluar Urdhërin për lejimin e Përmbarimit P.nr.166/2020, të datës 23.07.2020, të lëshuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Irfan Kërçagu në Prishtinë. Ndërsa vendosjen për anulim të veprimeve dhe përfundim të procedurës përmbarimore si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mbështet në nenin 73 paragrafi 4 sipas Ligjit Nr.05/L-118 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
PPP.nr.547/2021, dt.22.01.2024

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtut, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.